

RAPORTI STATISTIKOR

JANAR
2023

H y r j e

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për periudhën 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për periudhën janar të viteve 2019 - 2023. Në përfundim të raportit ndërtohen projeksione dhe jepen vlerësime të mbështetura në fakte dhe gjykime.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën janar 2023 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a.

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar 2023.....	1
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	7
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar 2023	9
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	11
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	11
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	13
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	13
2.5 Përpjesa e klasave të sigurimit në raport me totalin	14
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar 2023.....	15
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	16
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	17
4.Projeksione dhe vlerësime	17


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar 2023

Tregu i sigurimeve për muajin janar 2023 ka realizuar 1,712,041,500 lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës dhe Jo Jetës, duke shënuar rritje me 20.60% krahasuar me muajin janar 2022. 90.54% të këtyre primeve realizohet nga sektori i Jo Jetës, pjesa tjetër prej 9.46% nga sektori i Jetës, kurse veprimtaria e risigurimeve nuk gjeneron prime këtë periudhë. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 560,315,500 lekë në rritje me 42.51% krahasuar me muajin janar të vitit 2022. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 94.46% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 3.17% e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 2.38% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës

Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 1,550,131,500 lekë duke shënuar rritje me 18.01% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut e japin sigurimet e detyrueshme motorike me 11.46%, dhe sigurimet nga zjarri dhe dëmtimet e tjera në pronë me 43.71%. Ndikimi i tyre i rëndësishëm vjen nga përpjesa që ata kanë në totalin e tregut. Rritjen më të madhe nga llojet e sigurimeve e mban siguri i përgjegjësi civilë me +102.52%. Rënie paraqesin vetëm klasat e sigurimeve të aksidenteve dhe garancive ndërsa pjesa e tjetër e sigurimeve shënojnë rritje krahasuar me janar 2022. Në grafikun 1 ilustrohen vlerat në përqindje ndryshimi për secilën klasë sigurimi të periudhës janar 2023/2022.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar 2023/2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

Nga ana tjetër, sipas ecurisë së primeve të shkruara bruto të muajit janar për vitet 2019-2023 trendi i tyre është i çrregullt krahasuar me vitin paraardhës. Kurba e ecurisë së primeve të

tregut paraqet kulmin e saj në janar të vitit 2023. Vlera më e ulët e primeve të realizuara është në vitin 2022. Grafikisht, viti 2020 evidentohet si pikë thyerje nga ritmi i rritjes, pasi muaji janar 2022 është nën periudhën e rikuperimit ekonomik nga efektet e pandemis Covid 19. Bazuar në parashikimet e Bankës Botërore për vitin 2023, pritet që ekonomia e Republikës së Shqipërisë të ketë rritje ekonomike me afro 2.3%, duke parë edhe zhvillimet ekonomike dhe politike që do ndodhin gjatë vitit. Megjithatë, për ecurinë e tregut të sigurimeve, i cili ka pasur trend pozitiv që pas pandemisë, fakt pozitiv është edhe vlera më e lartë në janar të vitit 2023.


Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar 2019-2023 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori

Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e sigurimeve të detyrueshme motorike duke zotëruar 61.64% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas me rreth 12.63% nga sigurimet e pronës ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera. Ndarja e përpjesës së sigurimeve grafikisht paraqitet në grafikun 3, ku vihet re struktura pothuajse e njëjtë e llojeve të sigurimit që dominojnë tregun e sigurimeve si gjatë vitit 2022, afërsisht klasa e sigurimeve të detyrueshme humbet 3.70% të përpjesës, e cila fitohet nga klasa e sigurimit të përgjegjësive. Përpjesë humb edhe klasa e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve me afro 1.80% më pak.


Grafiku 3: Përpjesa e primeve bruto sipas të llojit të sigurimeve ndaj totalit, janar 2023



Burimi: AMF, përpunoi autori

Referuar grafikut 4, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për muajin janar përpjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në muajin janar të vitit 2021 me 42.32% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në muajin janar të vitit 2019, i cili rezulton afro 32.08%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 38.36% me 61.64%.

Grafiku 4: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar 2019-2023 (mijë lekë)




Burimi: AMF, përpunoi autori

Nga sigurimet e detyrueshme motorike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezultojnë të gjitha me rritje si, sigurimet TPL (+9.47%), kufitare (+4.39%), dhe kartoni jeshil (+25.56%). Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë muajit janar 2023 është 86,770 kontrata, duke shënuar rritje prej 17.93% më shumë se një vit më parë. Klasa e sigurimeve motorike vullnetare dhe marinë, aviacion dhe transport janë të vetmet klasa me


rënien në numrin e kontratave të nënshkruara, repektivisht -35.73% dhe -10.26%, ndërsa pjesa tjetër shënon rritje, ku rritjen më të madhe e mban klasa e sigurimeve të kreditit. Ndarja e tregut të Jo Jetes (grafiku 5). Ndërkohë, norma e rritjes së tregut është rreth 18.01% krahasuar me janar 2022 (grafiku 6) dhe raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit per janar 2023 (grafiku7).

Grafiku 5: Ndarja e tregut të Jo Jetës, janar 2023




Burimi: AMF, përpunoi autori

Grafiku 6: Norma e rritjes së primit, janar 2023/2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Grafiku 7: Raporti vullnetare/totalit, janar 2023




Burimi: AMF, përpunoi autori

1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës

Gjatë periudhës janar 2023 nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 529,258,234 lekë dëme, shifër në rritje krahasuar me janarin e vitit 2022, 49.34% më shumë dëme të paguara, kjo për shkak edhe të vlerës së ulët të dëmeve të një viti më parë.

Grafiku 8: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar 2019-2023




Burimi: AMF, përpunoi autori

Sipas ilustrimit dhe në grafikun 8, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është në muajin janar të vitit 2020 për gjithë periudhën e viteve 2019-2023. Faktori kryesor ndikues në këtë tregues janë tërmetet e ndodhura në fund të vitit 2019 në vend dhe pasojat që ata shkaktuan, duke bërë që vlera e dëmeve dhe për pasojë e dëmshpërblimeve nga siguruesit të jetë më e lartë së çdo vit tjetër gjatë vitit 2020. Gjatë muajit janar 2023, ndërkohë që rritet vlera e dëmeve të paguara, ulet numri i dosjeve të paguara, duke pësuar rënie të lehtë prej 1.14%. Rënia e numrit të dëmeve të paguara, vjen kryesisht nga klasa e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve. Nga ana tjetër në grafikun 9, për periudhën janar 2023 paraqitet ndryshimi në vlerën e dëmeve të paguara për janar 2023 krahasuar me janar 2022, ku siç ilustron me rënie paraqitet klasa e sigurimit të marinës dhe aviacionit dhe përgjegjësitë civile, të cilat në peshën e tyre ndaj totalit, nuk përbëjnë peshë të konsiderueshme. Pjesa tjetër e klasave janë në rritje, ku rritjen më të madhe e mban klasa e sigurimit të garancive me +3,232.22%. Edhe sigurimi ndaj palëve të treta shënon rritje me 18.72%.

Grafiku 9: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar 2023/2022¹

¹ Grafiku 9 nuk përfshin ndryshimin në dëmet e paguara për klasën e kreditit dhe garancisë, si pasojë e përqindjes shumë të lartë të ndryshimit (+3,232.22%), e cila në ilustrimin grafik do shpërfillte ndryshimet e tjera.




Burimi: AMF, përpunoi autori

Për pjesën më të madhe të klasave të sigurimit, ndryshimi në vlerën e dëmeve të paguara dhe numrit të dëmeve të paguara shkon në të njëjtin kah. Përveç sigurimit të aksidenteve, të cilat në vlerë rriten me 5.20%, ndërsa në numër bien me 6.09%, rrjedhimisht këtë periudhë bie frekuenca e pagesës së dëmeve, por rritet ashpërsia e dëmit.

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga lloji i sigurimeve motorike rreth 54.77% e totalit, ndjekur nga sigurimet zjarrit dhe dëmtimeve të pronës me 17.71% dhe pjesa tjetër nga të tjera.

Grafiku 10: Përpjesa e dëmeve të paguara sipas klasës së sigurimeve, janar 2023




Burimi: AMF, përpunoi autori

Referuar të dhënave, raporti dëme/prime rezulton të jetë 34.14% gjatë muajit janar 2023, afro 7.16% më shumë se raporti dëme/prime i vitit 2022. Raporti llogaritet për të matur efikasitetin e tregut të sigurimeve, duke treguar se ç'pjesë të primeve të grumbulluara shkon për pagesën

e dëmeve. Në vendet e zhvilluara ky raport është mbi 50%, megjithatë raporti duhet të variojë në varësi të natyrës së llojit të sigurimit. Për sigurimet e detyrueshme motorike, kjo klasë duhet të ketë raportin më të lartë dëme/prime, pasi në këtë mënyrë realizon qëllimin e aktivitetit të tij, afërsisht në tregun e vendit tonë ky raport për sigurimet e detyrueshme motorike është afro 30.34%. Megjithatë, raporti është tregues më i mirë kur në studim merret një periudhë më e gjatë kohe se një muaj. Pjesa më e madhe e dëmeve paguhen nga shoqëria Eurosig afro 23.05% të totalit të tregut, ndjekur nga shoqëria Sigma, Sigal dhe më pas Intersig.

Grafiku 11: Përpjesa e dëmeve të paguara nga secila shoqëri sigurimi, janar 2023




Burimi: AMF, përpunoi autori

2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar 2023

Nga krahasimi i të dhënave më të fundit të publikuara nga AMF për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën 2023, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 102,328 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 8.60% ose 8,100 mijë lekë më shumë krahasuar me janarin e vitit 2022 dhe një rritje prej 5.19% ose 5,050 mijë lekë më shumë në raport me janarin e vitit 2021. Krahasuar me janarin nga vitet 2019 – 2023, ecuria e primeve të shoqërisë Insig është pothuajse jo e rregullt, duke shënuar vlerën më të ulët në janar të 2019-ës dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në janar të vitit 2023 paraqitur grafiksht si më poshtë në grafikun 12.

Grafiku 12: Ecuria e primeve të shkruara bruto Insig, janar 2019-2023 në mijë lekë



Burimi: AMF & INSIG


Nga këndvështrimi i ndarjes më specifike të biznesit, në Sigurime të Detyrueshme dhe Vullnetare për periudhën janar 2023, rezultojnë përkatësisht strukturat e mëposhtme me dominancë të qëndrueshme të sigurimeve të detyrueshme.

Për Tregun 2023: Të Detyrueshme 62%, Vullnetare 38% (**janar 2022:** 65% me 35%).

Për INSIG 2023: Të Detyrueshme 84%, Vullnetare 16% (**janar 2022:** 82% me 18%).

Prej kësaj vihet re se, për Tregun kemi një zhvendosje me 3% nga sigurimet e detyrueshme drejt atyre vullnetare, ndërsa për Insig kemi zhvendosje në kah të kundërt me Tregun dmth nga sigurimet vullnetaret drejt atyre të detyrueshme po me 2%. Kemi një tendencë një rritje drejt sigurimeve vullnetare për Tregun dhe për Insig një tendencë një rënie për sigurimet vullnetare. Tregues jo i mirë rezultati në rënie i sigurimeve vullnetare për INSIG për këtë fillim viti të 2023 krahasuar me 2022. Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për janar 2023 është 15.92% me 84.08%, duke pasur një rënie të këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 18.41%. Ecuria e këtij raporti për periudhën janar 2019-2023 paraqitet sipas grafikut 13.

Grafiku 13: Prime vullnetare ndaj totalit Insig, janar 2019-2023 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

Duke ju referuar produkteve qe zënë peshën kryesore në totalin e të ardhurave, por edhe atyre për të cilat disponohen të dhëna nga tregu, konstatohet se pesha e INSIG ndaj Tregut ka ndryshuar respektivisht si më poshtë:

2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Aksidenteve e Shëndetit

Gjatë periudhës janar 2023 nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 2,036 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rënie me 12.87% ose 301 mijë lekë më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Kjo rënie është shoqëruar me rritjen e numrit të kontratave prej 30.74%. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin janë 1.99% e tyre. Grafiku 14, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar nga 2019–2023. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për muajin janar të vitit 2021, ndërsa më e larta për janarin e vitit 2022.

Grafiku 14: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve e shendetit Insig, janar 2019-2023 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike

Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike TPL, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar 2023 ka grumbulluar 91,636 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar rritje me 9.56% e cila u shoqërua edhe me rritjen e numrit të kontratave me 31.19% krahasuar me janarin e vitit 2022. Referuar krahasimit me janarin e vitit 2021, rezulton me një rritje prej 18.92%. Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 86,040 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 93.89% të gjithë primeve të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike për periudhën janar 2023, TPL zë pjesën më të madhe prej 77.57% dhe krahasuar më të njëjtë periudhë të 2022 ka rritje prej 9.62% dhe kjo u shoqërua edhe me rritjen e numrit të kontratave prej 10.07%. Kartoni Jeshil renditet i dyti me 14.33% të totalit të motorikeve dhe krahasuar më të njëjtë periudhë të 2022, ka një rritje prej 26.69% e cila u shoqërua edhe me rritjen e numrit të kontratave prej 332.57% ose 3 herë më të lartë se janari i vitit 2022. Kufitarja ze 2% të totalit të motorikeve dhe

ka një rritje prej 9.26%, e cila u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave prej 42.68%. Ndërkohë për periudhën janar 2023, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 5,596 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 17.16%, e cila u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave prej 1.12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Primet e kësaj klase zënë 6.11% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 84.08% të tij. Për periudhën janarin e viteve 2019–2023 trendi i primeve të sigurimeve të detyrueshme motorike është i luhatshëm, ku vlera më e ulët shënohet për janarin e vitit 2019 dhe vlera më e lartë në janarin e vitit 2023 sipas grafikut 15.


Grafiku 12: Ecuria e primeve - klase e sigurimeve motorike të detyrueshme Insig, janar 2019 - 2023 (mijë lekë)



Burimi: AMF & INSIG

Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar nga 2019 në 2023, ku vlera më e ulët shënohet në janar të 2019-ës dhe vlera më e lartë në janar të vitit 2021. Kemi një tendencë ulje dhe ngritje të këtij produkti, tregues jo shumë pozitiv duke marrë parasysh faktin që produktet Kasko bëjnë pjesë në produktet vullnetare. Në grafikun 16 ecuria e primeve Kasko 2019-2023.

Grafiku 13: Ecuria e primeve Insig – klase e sigurimeve kasko, janar 2019-2023 (mijë lekë)




Burimi: AMF

2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar 2023 është 1,880 mijë lekë, duke shënuar rënie prej 7.88 % e cila u shoqërua me rënien e numrit të kontratave me 31.28%, krahasuar me janarin e vitit 2022. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar 2023, kjo klasë realizon 1.84% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar nga 2019-2023 paraqitet në grafikun 17 , ku vihet re që vlera më e ulët i takon vitit 2019 dhe vlera më e lartë arrihet në vitin 2021.

Grafiku 14: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar 2019-2023 (mijë lekë)




Burimi: AMF & INSIG

2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të Garancive, Mallrave në Transport, Përgjegjësi, Aviacionit dhe Marinës. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar 2023, ky grup realizon 6.62% të totalit. Sigurimi i përgjegjësi zë peshën më të madhe në këtë grup, i ndjekur nga sigurimet e garancive dhe me pas klasat e tjera të sigurimeve sipas grafikut 18.

Grafiku 15: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar 2019-2023 (mijë lekë)




Klasa te Tjera,	2019	2020	2021	2022	2023
Sigurimi i garancive	285	803	1,614	1,466	170
Sigurimi mall në transport	0	0	0	1	0
Sigurimi i përgjegjësi	39	453	1,233	4,744	6,599
Sigurimi i avacionit	0	0	0	0	0
Sigurimi i marinës	1,536	7	16	0	7

Burimi: AMF & INSIG

2.5 Përpjesa e klasave të sigurimit në raport me totalin

Pesha specifike e të ardhurave të secilës klasë në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar 2023, paraqitet grafikisht si më poshtë. Nga paraqitja grafike shihet që pjesa më e madhe e primeve të realizuara vjen nga sigurimet motorike, e ndjekuar nga sigurimet e përgjegjësi, të pronës, të aksidenteve dhe shëndetit, të garancive dhe të marinës. Sigurimi i avionëve dhe i mallit në transport rezulton pa prime.

Grafiku 19: Pesha specifike e seciles klase ndaj totalit Insig, janar 2023.



Burimi: AMF & INSIG

Në pasqyrën e mëposhtme kemi paraqitjen e primeve të realizuara për periudhën janar 2023 për secilën klasë sigurimesh dhe ndryshimin në përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021 dhe 2022.

Tabala 1: Primet e shkruara sipas klasave të sigurimit Insig, 2023/2021, 2022 në mijë lekë


Klasat e sigurimeve	2021	2022	2023	Ndryshimi '23-'21/'21	Ndryshimi '23-'22/'22
Aksidente dhe shendet	344	2,336	2,037	492%	-13%
Sigurimi motorik	77,054	83,639	91,636	19%	10%
Sigurimi i marinës	16	-	7	-56%	0%
Sigurimi i avionëve	-	-	-	0%	0%
Sigurimi i pronës	17,017	2,042	1,879	-89%	-8%
Sigurimi i mall. në transp.	-	1	-	#DIV/0!	-100%
Sigurimi i përgjegjësive	1,233	4,744	6,599	435%	39%
Sigurimi i garancive	1,614	1,466	170	-89%	-88%
Total	97,278	94,228	102,328	5%	9%

Burimi: AMF & INSIG

3.Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar 2023

Referuar vleresimit për dëmet e paguara për periudhën janar 2023 shoqëria INSIG rezulton me 42,111 mijë lekë pagesa duke pësuar një rritje me **75.48%**, krahasuar me nivelin e dëmeve të paguara për të njëjtën periudhë të vitit 2022 ku niveli i pagesave kapte vlerën prej 23,997 mijë lekë. Ndërkohë numri i dëmeve të paguara është ulur me **53.66%** ose 44 raste më pak krahasuar me janarin e vitit 2022. Raporti dëme/prime për periudhën janar 2023 rezulton të jetë **41.15%**. Për INSIG, pjesa më e madhe e vlerës së pagesave për muajin janar 2023 i takon sigurimeve të Garancive të cilat zënë 82.92% të totalit të pagesave i ndjekur nga sigurimet Motorike me 16.83% të totalit të pagesave. Ndikim më të madh në këtë grup ka dhënë Kartoni Jeshil me 9.22% të pagesave, e ndjekur nga TPL me 6.70%, Kasko me 0.91% dhe Kufitare rezulton pa deklarime dhe pagesa për këtë periudhë të vitit 2023. Më pas vijnë pagesat e kryera nga klasa e Aksidenteve e Shëndetit që zënë 0.25%. Zjarri dhe Dëmtimet e tjera në Pronë, Transporti dhe Sigurimet e Përgjegjësive rezultojnë pa deklarime rastesh dhe pagesa për këtë periudhë të vitit 2023. Më poshtë grafiku 20, paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave që zë secila klase ndaj totalit, për periudhën janar 2023.


Grafiku 20: Pjesa e dëmeve të paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar 2023



Burimi: AMF & INSIG

Duke ju referuar ecures së pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar nga viti 2019-2023, kemi një luhatje pagesash. Janari i vitit 2019 shënon raportin më të lartë të dëmeve të paguara kundrejt primeve të realizuara, ndërsa janari i vitit 2020 shënon raportin më të ulët. Referuar muajit Janar të vitit 2023 kemi vlerën më të lartë të dëmeve të paguara dhe një raport prej 41.15% të dëmeve të paguara kundrejt primeve të realizuara. Më poshtë ecuria e dëmeve të paguara dhe raporti dëme/prime për Insig, për periudhën janar 2019-2023 sipas grafikut 21 (në mijë lekë).

Graiku 21: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar 2019-2023 (mijë lekë)



Burimi: AMF & INSIG

1. 3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike


Sigurimeve motorrike për periudhën janar 2023, kapin vlerën prej 7,089 mijë lekë ose **16.83%** të totalit të pagesave. Nga karahasimi me janarin e vitit 2022, kemi një rënie prej 69.86% ose 16,427 mijë lekë më pak. Brenda grupi 5.40% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar

Kasko dhe pjesa tjetër prej 94.60% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike. Referuar krahasimit me janarin e vitit 2022, TPL rezulton me rënie prej 84.34%, Kartoni Jeshil rezulton me rritje prej 67.49%, Kasko rezulton me rënie prej 66.31%, ndërsa Kufitare rezulton pa deklarime pagesash për janarin e vitit 2023.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara sic u përmend edhe me lart i takon sigurimit të Garancive me rreth 34,917 mijë lekë ose 82.92% të totalit të pagesave. Raporti dëme të paguara ndaj primeve të realizuara për sigurimet e Garancive është shumë i lartë. Për klasën e sigurimeve të Pronës, Transporteve dhe Përgjegjesive nuk kemi deklarime rastesh dhe pagesa për janarin e vitit 2023. Përsa i përket Aksidenteve dhe Shëndetit për periudhën janar 2023, shënohen rreth 105 mijë lekë pagesa ose 0.25% të totalit të pagesave. Referuar krahasimit të kësaj klase, me janarin e vitit 2022, rezulton një rënie prej 78.17%. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara për këtë klasë është 5.16% për janarin e vitit 2023. Kjo klasë në raport me pagesat totale të tregut zë 0.23% të këtij totali. Grafikisht më poshtë, kemi një paraqitje të ecurisë së pagesave për periudhën janar 2022-2023 dhe ndryshim në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 22: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje Insig, janar 2022-2023 (në mijë lekë)




D.Paguara	TPL	Karton Jeshil	Kufitare	Kasko	Aksid, & Shend,	Zjarr	Garanci	Transport
2022	18,023	2,319	2,037	1,137	481	-	-	0
2023	2,822	3,884	-	383	105	-	34,917	0
Ndys%.%	-84.34%	67.49%	-100.00%	-66.31%	-78.17%	0.00%	0.00%	0.00%

4.Projeksiione dhe vlerësime

Për periudhën janar të vitit 2023, shoqëria INSIG per aktivitetin e Jo Jetës shënoi një rritje në

totalin e primeve të realizuara me rreth **8.60%** ose 8,100 mijë lekë më shumë, e cila u shoqërua me rritjen e numrit të kontratave për këtë aktivitet me **34.14%** ose 1,610 kontrata më shumë krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit 2022. Një rritje e konsiderueshme duke marrë parasysh situatën ekonomike në botë e cila ka dhënë ndikimin e vet edhe në vendin tonë me rritjen e cmimeve dhe inflacionin. Vlen të theksohet fakti që, pavarësisht peshës aktuale në treg prej **6.60%** efeketi i INSIG ka ndikimin e tij pozitiv në rritjen e Tregut, po në një masë jo shumë të ndjeshme pasi të gjitha kompanitë rezultojnë me rritje për periudhën janar 2023 krahasuar me janar 2022. Tregu i Jo Jetes në vetvete shënon një rritje prej **18.01%** dhe kjo u shoqëruar me rritjen e numrit të kontratave në total për tregun prej **17.93%** ose **13,139** kontrata më shumë. Duke ju referuar ritmit të rritjes së Tregut të Jo Jetes në përgjithësi dhe rritjes të INSIG-ut në veçanti, për periudhën janar 2023 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, grafikisht më poshtë vihet re se, për sigurimet vullnetare norma e rënies së INSIG-ut është më e vogël se norma e rritjes së Tregut. Diferenca e Insig-ut me Tregun për sigurimet vullnetare është rreth 35.82% më pak. Mirëpo kjo vjen edhe nga baza e ulët e vullnetareve për periudhën janarin e vitit 2019 për INSIG. Nga ana tjetër, norma e rritjes së sigurimeve të detyrueshme për INSIG është më e lartë se ajo e rritjes së Tregut, me një diferencë prej 0.56% më shumë. Bazuar në këto tregues për këtë muaj të parë të vitit 2023, për shoqërinë INSIG lind nevoja në vazhdimësi për vitin 2023, fokusi të vihet të rritja e sigurimeve vullnetare. Megjithatë, sigurimet motorike të detyrueshme, të cilat ecin në të njëjtin trend me ecurinë e tregut, pritet të shënojnë rritje me përmirësimin e treguesve të tjerë ekonomik.


Grafiku 24: Norma e rritjes së tregut të sigurimeve dhe Insig, janar 2023/2022



Trendi i primeve të tregut të sigurimeve dhe i shoqërisë INSIG ka qenë i luhatshëm dhe me shpërndarje jo normale. Sidomos gjatë vitit 2020, të gjitha modelet parashikuese rezultuan jo të sakta, si pasojë e faktorëve të mjedisit të jashtëm, ku pandemia globale Covid 19 pati ndikimin thelbësor.

Bazuar në të dhënat historike të primeve për INSIG, grafikisht më poshte sipas figures 1, paraqitet parashikimi i primeve për muajt shkurt 2023–korrik 2023. Modeli parashikues është ndërtuar në tre skenar të cilët bazohen në të dhëna historike. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten vetëm të dhënat historike për primet tetor 2022 - dhjetor 2022, por në ndërtimin e parashikimit janë marrë si bazë të dhënash, primet mujore që nga viti 2013 dhe projeksioni vijon deri në fund të vitit 2025. Parashikimet bazuar në të dhënat historike, nuk janë modelet më të mira parashikuese, duke marrë parasysh faktin që, mjedisi në të cilin operon shoqëria ka ndryshuar dhe është në ndryshim të vazhdueshëm

Figura 1: Parashikimi i primeve Insig Shkurt 2023 –Korrik 2023 (në mijë lekë)



Burimi: Të dhëna Insig, përpunoi autori